

Kompania Rajonale e Ujësjesit
“ **HIDRODRINI** ” SH.A.
Pejë

Raport i Auditorit të Pavarur

Për vitin kalendarik që përfundon
me 31 Dhjetor 2019

Përmbajtja	Faqe
Raporti I Auditorit të Pavarur	2-4
Pasqyra e Gjendjes Financiare	5
Pasqyra e të Ardhurave	6
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	7
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	8
Shënime mbi Pasqyrat Financiare	9-21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e KRU "Hidrodrini" SH.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KRU "Hidrodrini" SH.A. të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë me datën 31 Dhjetor 2019, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë (SNRF), dhe për kontrollet e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuadojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku I mos zbulimit të një anomalie material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë përveç të tjerash, edhe përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative

Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KRU "Hidrodrini" SH.A. si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10.

Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor të KRU "Hidrodrini" SH.A. për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019, më datë 31.10.2019 nga menaxhmenti/aksionarët e kompanisë.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

"Audit Check" shpk

Haxhi Nimanaj, auditor ligjor
Datë ,19.06.2020



**Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2019**

	Shënimi	2019	2018
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3.3	7,756,047	6,140,380
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	11,798,360	11,532,301
Stoqet	3.5	517,497	490,333
Pasuritë e tjera afatshkurtra	3.4.1		2,885
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		20,071,905	18,165,899
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	3.2	17,064,738	18,137,436
Investimet në vijim	3.2	7,749,631	1,421,850
Gjithsej pasuritë afatgjata		24,814,369	19,559,285
Gjithsej pasuritë		44,886,274	37,725,185
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	108,465	67,814
Tatimet e pagueshme aktuale		2,345,756	2,409,709
Të hyrat e shtyra	3.7.1	21,759,745	14,789,665
Përfitimet e punonjësive të pagueshme		14,979	15,204
Detyrimet e tjera afatshkurtra	3.7	10,987	10,093
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		24,239,932	17,292,485
Detyrimet afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet		24,239,932	17,292,485
EKUITETI			
Kapitali aksionar	3.13	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	3.13	- 1,123,212 -	1,336,854
Rezervat e tjera		21,744,554	21,744,554
Gjithsej ekuiteti		20,646,342	20,432,699
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		44,886,274	37,725,185

Kryeshefi ekzekutiv

Agron Tigani



Zyrtari i larte financiar

Rasim Maloku

Kontabilisti i qertifikuar

Xhevat Rexhepi

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH.A.- PEJË**



Rr. Lekë Dukagjini nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Shënimi	2019	2018
Të hyrat	3.6	3,914,097	3,724,540
Kostoja e shitjes	3.9	-	-
Fitimi / (humbja) bruto		3,914,097	3,724,540
Të ardhurat tjera	3.6	527,392	499,468
Shpenzimet e shpërndarjes	3.10.2	1,918,552	1,994,052.60
Shpenzimet administrative	3.10.1	2,275,548	2,194,752.00
Fitimi / (humbja) operativ		247,388	35,204
Shpenzimet financiare	3.10.3	-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		247,388	35,204
Shpenzimet e tatimit në fitim	3.14	33,746	
Fitimi / (humbja) i/e vitit		213,642	35,204
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të v		213,642	35,204

Kryeshefi ekzekutiv

Agron Tigani



Zyrtari i lartë financiar

Rasim Maloku

Kontabilisti i qertifikuar

Xhevat Rexhëpi

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH.A.- PEJË



Rr. Lekë Dukagjini nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2018	25,000 -	1,372,058	21,744,554	20,397,496
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	35,204	-	35,204
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25,000 -	1,336,854	21,744,554	20,432,699
Gjendja më 1 janar 2019	25,000 -	1,336,854	21,744,554	20,432,699
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	213,642	-	213,642
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,000 -	1,123,212	21,744,554	20,646,342

Kryeshefi ekzekutiv

Agron Tigani



Zyrtari i lartë financiar

Rasim Maloku

Kontabilisti i qertifikuar

Xhevat Rexhepi

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

Shënimi	2019	2018
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	213,642	35,204
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2 1,574,672	1,618,333
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	1,822,061	1,653,536
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4 - 266,060	- 493,443
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	3.5 - 27,164	58,876
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	3.4.1 2,885	1,592
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8 40,651	- 12,017
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	3.7 6,906,796	- 44,810
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	8,445,422	1,163,734
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2 - 6,829,756	- 1,019,659
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	- 6,829,756	- 1,019,659
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	3.7 -	4,995,231
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	4,995,231
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	1,615,666	5,139,306
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	3.3 6,140,380	1,001,074
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	7,756,046	6,140,380

Kryeshefi ekzekutiv

Agron Tjani



Zyrtari i lartë financiar

Rasim Maloku

Kontabilisti i qertifikuar

Xhevat Rexhepi

1. Informata të përgjithshme

KRU "Hidrodrini" Sh.A, Pejë, më tutje "Kompania" është shoqëri aksionare e inkuorporuar me 01.06.2007 në Kosovë , sipas Projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit në Kosovë me numer te biznesit: 70433918, numer fiskal 600198867 dhe Numer Unik Identifikues 811336975.

Kompania është themeluar në pajtim me ligjin mbi shoqëritë tregtare 02/L-123.
Adresa e zyrës qendrore të regjistruar është në rrugën: Lekë Dukagjini nr.156, Pejë, Kosovë.

Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000 Euro.
Librat e Kompanisë janë hapur me 01 Janar 2009 bazuar në Pasqyrën e Gjendjes Fillestare.

KRU "Hidrodrini"Sh. A. është institucion publik profesional i licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, për ofrimin e shërbimeve baze, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet kanalizimit.

Numri popullatës që KRU,,HIDRODRINI" iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 185.000 banor, ndërsa shërbimet e ujërave të zeza 60,000 banor.

AKTIVITETI PRIMAR

3600 Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë

AKTIVITETI SEKONDAR

4313 Testi i shpuarjes dhe shpuarja

AKTIVITETET TJERA

7734 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e pajisjeve të transportit ujqor

7112 Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik

3530 Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar

4941 Transporti rrugor i mallrave

9329 Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit

7732 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve të ndërtimtarisë dhe inxhinierisë

8299 Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t.

8411 Aktivitetet e përgjithshme të administratës publike

4322 Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit, etj.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM
FINANCIAR**

2.1 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2019):

- **Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet Financiare**

Më 12 tetor 2017, BSNK publikoi 'Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshime në SNRF 9)' për të adresuar shqetësimet rreth asaj se si SNRF 9 'Instrumentet Financiarë' klasifikon aktivet financiare të veçanta të parapagueshme. Përveç kësaj, BSNK sqaroi një aspekt të kontabilitetit për pasivet financiare pas një modifikimi. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive për vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

- **KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat**

KIRFN 23 është lëshuar nga BSNK më 7 qershor 2017 dhe është efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, me leje të lejuara më parë.

- **SNRF 16 Qiratë**

SNRF 16 ofron një model gjithëpërfshirës për identifikimin e marrëveshjeve të qirasë dhe trajtimin e tyre në pasqyrat financiare për të dy qiramarrësit dhe qiradhënësit. SNRF 16 do të zëvendësojë udhëzimet aktuale të qirasë duke përfshirë SNK 17 Qiratë dhe interpretimet përkatëse kur të hyjë në fuqi për periudhat kontabël që fillojnë në ose pas 1 janar 2019.

- **Ndryshime në SNK 28 Interesat Afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta**

Më 12 tetor 2017, BSNK publikoi "Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)" për të sqaruar se një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" për interesat afatgjatë në një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët që formon pjesë e investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, por për të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive për vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

- **Ndryshime në SNK 19 Përfitimet e punonjësve Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja**

Më 7 shkurt 2018, BSNK publikoi 'Ndryshimin e Planit, Reduktimin ose Zgjidhjen (Ndryshimet në SNK 19)' për të harmonizuar praktikat kontabël dhe për të dhënë informacion më të rëndësishëm për vendimmarrje. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për ndryshimet në plan, reduktimi ose zgjidhja që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019.

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU "Hidrodrini", për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

2.2 Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- **Ndryshimet në fazën e pare të reformës në Librin e Regjistrimëve të Investimeve (IBOR)**
Më 26 Shtator 2019, BSNK lëshoi 'Reformën në Standardin e Normave të Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)' si një reagim i parë ndaj efekteve të mundshme që reforma IBOR mund të ketë në raportimin financiar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020.
- **Ndryshimet në SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit***
Më 22 tetor 2018, BSNK lëshoi 'Përcaktimi i një biznesi (Ndryshime në SNRF 3)' që synojnë zgjidhjen e vështirësive që shfaqen kur një entitet përcakton nëse ka siguruar një biznes apo një grup të pasurive. Ndryshimet janë efektive për kombinimet e biznesit për të cilat data e përvetësimit është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 Janarit 2020.
- **Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 *Përkufizimi i Ri i Materialitetit***
Më 31 tetor 2018, BSNK lëshoi 'Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)' për të sqaruar përkufizimin e 'materialit' dhe për të lidhur përkufizimin e përdorur në Kornizën Konceptuale dhe vetë standardet. Ndryshimet janë efektive për periudha të raportimit vjetor që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020.
- **Referencat e Perditësuara në Kornizën Konceptuale**
Së bashku me 'Kornizën Konceptuale' të rishikuar të publikuar në Mars 2018, BSNK lëshoi gjithashtu 'Ndryshime në Referenca të Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF'. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2020.
- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimit**
SNRF 17 kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe të sigurojnë një qasje më të njëtrajtshme të matjes dhe prezantimit për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë të dizajnuara për të arritur qëllimin e kontabilitetit konstant të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve që nga 1 Janari 2021.
- **Ndryshimet në SNK 1 *Klasifikimin e Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale***
Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretime ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Kompanisë.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**3 . PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
dhe Shpalosja e Pasqyrave Financiare per vitin 2019**

3.1 Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza historike të kostos përveç rivlerësimit të pasurisë së caktuar për asete dhe detyrime të caktuara që janë vlerësuar me vlerën reale.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro (€), cila është edhe monedha funksionale për Kompaninë. Euro (€) është valuta kombetare në Kosovë.

3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Ndërtesat 5%

Pajisjet, Makinerite, Veturat etj. 20%

Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në mënyrë të ngjashme, në çdo datë të raportimit, stoqet vlerësohen për rënie të vlerës duke krahasuar vlerën kontabël neto të çdo artikulli të stoqeve (ose grupit të artikujve të ngjashëm) me çmimin e tij të shitjes minus kostot e shitjes. Nëse një artikull i stoqeve (ose grupi i artikujve të ngjashme) është i dëmtuar, vlera e tij kontabël reduktohet për çmimin shitës minus kostot e shitjes, dhe humbja nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) më pas kthehet, vlera kontabël e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet për vlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikuperueshme (çmimi shitës

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ", për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

minus kostot e e shitjes, në rastin e stoqeve), por jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do ishte njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë për pasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

3.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë të holla në bankë dhe në dorë. Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë para në dorë dhe të parave të gatshme të mbajtura në bankat, duke përfshirë depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

3.4 Të arkëtueshme dhe kerkesat tjera tregtare

Të arkëtueshmet tregtare janë regjistruar fillimisht me shumën e arkëtuar kundrejt shitjes së produkteve. Më pas të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në koston nominale minus lejimi për borxhet e dyshimta.

3.5 Stoqet

Kostoja e stoqeve përfshinë kostot e ndërlidhura drejtpërdrejt me blerjet, njësitë e shitjeve. Raportimi i stoqeve është bërë me çmimin e koston.

3.6 Njohja e të Hyrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme. Të ardhurat zvogëlohen për kthimet e konsumatorëve, zbritjet dhe lejimet tjera të ngjashme.

3.14 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të periudhës aktuale dhe të tatimit të shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në llogaritë e fitimit (humbjes), përveç pjeses që lidhet me elementët që njihen drejtpërdrejt në llogarinë e kapitalit ose në të tjera të ardhura permbledhëse.

3.14.1 Tatimi i periudhës aktuale

Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit.

3.14.2 Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshëm në të ardhmen dhe çdo humbje tatimore ose kreditim tatimor të papërdorur. Pasuritë e shtyra tatimore maten me shumën më të lartë që, në bazë të fitimit të tatueshëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar, ka më shumë gjasa që të rimerret sesa që të mos rimerret.

Vlera kontabël neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit dhe rregullohet për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme në të ardhmen. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

3.7 Detyrimet

Një detyrim njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Kompanisë i linden detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

3.8 Llogarit e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

Llogarit e Pagueshme njihen kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për te paguar këtë shumë ekziston si rezultat i veprimtarive ekonomike. Ato paraqiten sipas kostos.

3.7 Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

3.10 Shpenzimet e periudhës

Shpenzimet janë njohur në momentin e ndodhjes

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në datën e kryerjes së shërbimit, marrjes së përfitimit ose në datën e origjinës.

Kostot e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.2 Makineritë dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesat	Pajisjet, Makinerite, Veturat, TI etj	Rrjeti i Ujit, Ujmatesit, Lidhjet shtepiake	Investimi ne Vijim	Gjithsej
	€	€	€	€	€	€
Kostoja						
Më 1 janar 2019	2,304,250	6,214,601	1,579,397	24,004,503	1,421,850	35,524,601
Shtesat gjatë vitit	-	23,644	414,689	63,641	6,327,782	6,829,756
Më 31 dhjetor 2019	2,304,250	6,238,245	1,994,086	24,068,144	7,749,631	42,354,357
Zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi						
Më 1 janar 2019	-	2,267,270	1,496,747	12,201,298	-	15,965,315
Zhvlerësimi vjetor	-	311,222	77,601	1,185,849	-	1,574,672
Më 31 dhjetor 2019	-	2,578,492	1,574,348	13,387,147	-	17,539,988
Vlera neto						
Më 31 dhjetor 2019	2,304,250	3,659,753	419,738	10,680,997	7,749,631	24,814,369

3.3 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Paraja në arkë	494	43
Paraja në bankë	7,755,553	6,140,337
Gjithsej	7,756,047	6,140,380

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.4 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Të arkëtueshmet tregtare – neto	18,282,861.10	11,532,301.13
Provizionimet e LLA	- 6,604,248.97	
Llogarit e arketueshme Neto	11,678,612.13	
Të arkëtueshmet tjera	119,748.36	2,885.08
Gjithsej llogaritë e arketushme	11,798,360.49	11,535,186.21

3.5 Stoqet

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Stoqet ne Depo	517,497	490,333
Gjithsej Stoqet	517,497	490,333

3.7 Detyrime

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
<u>Detyrime afatshkurtëra</u>		
Obligimi për Tvsh	2,336,301	2,400,139
Pagat e Pagueshme	(59)	-
Tatimi ne paga l pagueshëm	9,457	9,570
Kontributi i pagueshëm	15,038	15,204
Te Hyrat e Shtyera (Grantet) *3.7.1	21,759,745	14,789,665
Llogaritë e Pagueshme/Furnitorët *3.8	108,465	67,814
Detyrime tjera afatshkurtëra	10,987	10,093
Gjithsej Detyrimet Afatshkurtëra	24,239,933	17,292,485
Gjithsej Detyrimët	24,239,933	17,292,485

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodriini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.7.1 Te Hyrat e Shtyera (Grantet)

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
Te hyrat e shtyera kfw	9,901,687	4,436,056
Te hyrat e shtyera Usaid	2,092,890	2,092,890
Te hyrat e shtyera mzhe	1,213,848	1,213,848
Te hyrat e shtyera cds Zvicer	609,692	609,692
Te hyrat e shtyera MMPH	3,800,000	3,800,000
Te hyrat e shtyera KK PEJË	2,597,481	1,093,031
Te hyrat e shtyera KK KLINË	1,445,783	1,445,783
Te hyrat e shtyera KOMUNITETI	98,365	98,365
Gjithsej Te Hyrat e Shtyera	21,759,745	14,789,665

3.13 Kapitali dhe Rezervat

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Kapitali themelues	25,000	25,000
Fitimet/(Humbjet) e bartura ne filim te vitit	(1,336,854)	(1,372,058)
Fitimi/(Humbja) e vitit	213,642	35,204
Rezervat e Rivleresimit/Tjera	21,744,554	21,744,554
Gjithsej ekuiteti	20,646,342	20,432,699

3.6 Te hyrat

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Te hyrat nga shitja/sherbimet	3,914,097	3,724,540
Te hyrat per asetet e zhvlersuara nga grantet	469,253	463,899
Te hyrat tjera	58,139	35,569
Gjithsej te hyrat	4,441,489	4,224,008

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.10.1.1 Kosto e personelit

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Pagat neto	1,434,878	1,631,043
Tatimi ne paga	84,853	
Kontributi i puntorit	79,869	
Kontributi shendetesor	8,316	
Pagat Bruto	1,607,916	1,631,043
Kontributi i pundhensesit	79,869	-

3.10.1 Shpenzimet Administrative

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Shpenzimet e Energjis Elektrike	474,819	475,247
Shpenzimet e Zyres	18,495	
Shpenzimet e perfaqsimi	5,365	5,269
Shpenzimet e Telefonit dhe Internetit	17,947	18,545
Shpenzimet e Donacioneve	3,950	879
Shpenzimet Komunale	4,284	2,923
shpenz.e borgjeve te kqija dhe te dyshimta	62,903	60,846
Shpenzimet Pagave *3.10.1.1	1,687,785	1,631,043
Gjithsej Shpenzimet Administrative	2,275,548	2,194,752

3.10.2 Shpenzimet e Shperndarjes

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Shpenzimet e Reklames	3,102	2,490
Shpenzimet e Karburanteve	57,698	54,143
Shpenzimet e Qerase	1,449	2,660
Shpenzimet e Sigurimit / Regjistrimit	15,625	12,950
Shpenzimet e Mirmbajtjes /Servisimit	119,580	119,120
Shpenzimet e Zhvlersimit	1,574,672	1,618,333
Shpenzimet tjera te shperndarjes	146,426	184,357
Gjithsej shpenzimet e shperndarjes	1,918,552	1,994,053

4. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

4.1 Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Menaxhmenti i Kompanisë konsideron se vlerat kontabël të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuara në pasqyrat financiare ngjajnë me vlerën e tyre reale për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër.

4.2 Menaxhimi i rrezikut

Aktivitetet e Kompanisë e ekspozojnë atë në një shumëllojshmëri të rreziqeve financiare, duke përfshirë:

- (a) rreziku kapital
- (b) rreziku kreditor
- (c) rreziku i likuditetit
- (d) rreziku i tregut

Ky shenim paraqet informacion rreth ekspozimit të Kompanisë ndaj secilit prej rreziqeve të mesiperme, objektivat, politikat dhe proceset e Kompanisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit.

Korniza e menaxhimit të rrezikut

Bordi i Drejtoreve mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikqyrjen e politikave të Kompanisë për menaxhimin e rrezikut. Bordi gjithashtu është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të riskut të Kompanisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Kompanisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Kompania, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Kompania, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Drejtimi kryen monitorimin e përditshëm për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet, duke zbatuar praktikatat me të mira.

4.2.1 Menaxhimi i Rrezikut kapital

Objektivat e kompanisë kur menaxhojnë kapitalin janë:

- të ruajnë aftësinë e tyre për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë së biznesit, në mënyrë që ata të mund të vazhdojnë të ofrojnë kthime për aksionarët dhe përfitimet për palët e tjera të interesuara, dhe
- të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit.

4.2.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i mos - pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet e saj për të paguar llogaritë e arkëtueshme të Kompanisë. Rreziku maksimal i kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht e barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve ndaj debitorit të njëjtë kur kompensimi është i lejuar.

Politika e Kompanisë është për të mbledhur paraprakisht shërbimet e faturuara ndaj klienteve, ose duke marrë depozita nga ata, ndërsa sa i përket klienteve/debitoreve që nuk arrijnë të paguajnë për shërbimet, Kompania fillon me mbledhjen, procedurat gjyqësore dhe masat, në baze të politikave përkatëse mbledhjes.

4.2.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimin të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Pikepamja e Kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është për të siguruar, aq sa është e mundur, që ajo do të ketë gjithmone likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohën e duhur, si në kushte normale dhe në kushte të renda, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikun e demtimit të reputacionit të Kompanisë.

4.2.4 Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të cmimeve të tregut, sic janë kurset e kembimit, normat e interesit dhe cmimet e kapitalit që do të ndikojnë të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare që mban ai. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është për të menaxhuar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

a) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të kembimit

Kjo është një formë e rrezikut që rrjedh nga ndryshimi i cmimit të një monedhe kundrejt një tjetre. Rreziku i monedhes është menaxhuar duke monitoruar pozicionet e hapura valutore. Rreziku i monedhes menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes aktive/detyrime dhe përmes kontributeve të pronareve. Kompania operon kryesisht në Euro.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese KRU " Hidrodrini ",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

Zotimet

Më 31 dhjetor 2019, Kompania nuk ka pasur zotime.

Detyrimet kontingjente

Nuk ka raste të evidentuara të gjykatës ose depozita lidhur me kompaninë, drejtorët ose punëtorët e kompanisë që mund të rezultojë me detyrime në të ardhmen.

Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që kërkon korrigjime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me date 30.04.2020.